



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 39, datë 17.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: “RESORT TURISTIK “BLUE BORG” ME 33 STRUKTURA AKOMODUESE DHE SHËRBIMI ME 3 DHE 10 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, 1 STRUKTURË AKOMODUESE TIP HOTEL ME 1 DHE 3 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, 3 STRUKTURA SOCIAL KULTURORE ME 1 DHE 3 KATE MBI TOKË”, ME VENDNDODHJE NË BAKS-RRJOLL, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvilluesit shoqërisë “ABA Blue Borgo” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort Turistik “Blue Borgo” me 33 struktura akomoduese dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, 1 strukturë akomoduese tip hotel me 1 dhe 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, 3 struktura social kulturore me 1 dhe 3 kat mbi tokë”, me vendndodhje në Baks-Rrjoll, Bashkia Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë “ABA Blue Borgo” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINIËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 08/08/2025